



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 186/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Nisma për Kosovë, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Konstatohet e tërhequr ankesa** me numër: Anr 159/2014 e datës 05.06.2014, e parashtruar në PZAP nga subjekti politik Nisma për Kosovë

**Arsyetim**

PZAP, me datë 06.06.2014, ka pranuar një kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr.159/2014 të datës 05.06.2014, të parashtruara në PZAP kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në të cilën kërkohet që të tërhiqet nga shqyrtimi ankesa e lartpërmendur.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të sipërshtuar, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos të shqyrtohen ankesa në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 186/2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**

